*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

E enjte, 18 nëntor 2021

[Seancë e hapur]

[I Akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 9.30

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës, kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Së pari, të shikojmë kush janë të pranishëm në anën e djathtë. Shoh të njëjtën përbërje, megjithatë të pyes znj. Prokurore.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës, mirëdita të gjithëve. Po Zyra e Prokurorit të Specializuar ka të njëjtën përbërje si dje, d.m.th. Prokurori Cezary Michalczuk; Menaxhere e Lëndës Julie Mann; stazhiere e brendshme Deborah Osborne; dhe unë, Ndihmës Prokurore Silvia D'Ascoli.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësja e Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve. Sot përfaqësohet Mbrojtja e Viktimave nga Njomza Haxhibeqiri, Ndihmëse Juridike, Liesbeth Zegveld, bashkëmbrojtëse, dhe unë vetë si mbrojtëse me emrin Anni Pues.

Duhet që të shtoj gjithashtu, ju kërkoj ndjesë paraprakisht në vartësi të kohëzgjatjes sot të seancës do të

më duhet që pa u ndier të largohem nga salla për një çështje tjetër, por do të jemi gjithashtu të përfaqësuar gjithsesi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Avokati Mbrojtës, keni fjalën.

Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës. Mbrojtja përfaqësohet nga unë, Julius von Bone; pastaj nga bashkëmbrojtësi Betim Shala dhe nga përkthyesi dhe hetuesi Fatmir Pelaj.  Z. Mustafa na bashkohet me videolidhje.

Me lejen tuaj dëshiroj që të trajtoj një çështje por më mirë që kjo të bëhet në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Ne të përfundojmë njëherë formalitetet pastaj do vazhdojmë.

Për procesverbalin z. Mustafa jeni të pranishëm. Na dëgjoni mirë?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e nderuara Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Për procesverbalin, ky proces zhvillohet përpara Trupit Gjykues I. Përpara se të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitares, i lutem Sekretares të na kalojë në seancë private në mënyrë që të diskutojmë çështjen që dëshiron të ngrejë Avokati i Mbrojtjes.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.

Z. Avokat keni fjalën.

Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë e nderuara Gjykatëse.

Ka një problem përkthimi sa i takon njërës prej deklaratave të dëshmitares. E kam fjalën për intervistën që ky person ka dhënë në Pjesën 1, në faqen 19. Më saktë është rreshti 15 deri në rreshtin 17.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare ju lutem të na e nxirrni në ekran.

Shoh që është ngritur në këmbë dhe znj. Prokurore. Keni fjalën.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk më kujtohet nëse është përdorur kjo pjesë apo jo, kështu që nuk jam e sigurt nëse ka ndonjë problem në përkthim. Po qe se nuk është përfshirë në transkript mund të mos ketë lidhje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta bëj unë pyetjen lidhur me këtë.

A mund t'i përsërisni rreshtat zoti avokat?

Z. VON BONE: [Përkthim] Po, transkripti në anglisht është në rreshtin 15 deri në 17. Në veçanti me një fjalë që

përmendet në rreshtin 17, aty ku thuhet "*[REDAKTUAR]*". Në versionin shqip të transkriptit përdoret një fjalë tjetër e cila është më shumë për "*[REDAKTUAR]*". Nuk e dimë sesi mund të zgjidhet një problem i tillë nëse ka probleme që mund të lindin. Sepse kjo ka lidhje edhe me dëshmitaren në të ardhmen, d.m.th. transkripti sigurisht tregon atë që zhvillohet këtu por ne do të donim të dinim sesi mund t'i zgjidhim këto çështje nëse ka ndonjë mospërputhje, duke qenë se dëshmitarja në këtë pjesë tregon diçka sa i takon shkakut të vdekjes dhe një fjalë e tillë mund të na çojë në diskutim lidhur me këtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit që e ngritët këtë.

Znj. Prokurore në fakt e tha, që nuk është përdorur në provat në gjykim. Por mund të them që Trupi Gjykues në fakt do të bëjë pyetje enkas në lidhje me këtë pikë të deklaratës së dëshmitares, që po qëndron çështja e ngritur dhe do të zgjidhet në momentin e duhur. Kështu mendoj se është mirë, do të ishte mirë që t'u kërkojë përkthyesve nëse do të ishin të gatshëm që të bënin krahasim për këtë pjesë në veçanti. Sigurisht ata - pastaj do të shikojmë pra sesi mund të krahasohen të dy përkthimet.

[Anëtarët e Trupit Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësja e Viktimave keni fjalën.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Një sugjerim i shkurtër të nderuar Gjykatës, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*, sepse mbase mund ta zgjidhë këtë çështje në mënyrë më të thjeshtë domethënë lidhur me atë pyetjen – kjo ka lidhje dhe me pyetjen e përgjithshme, çështjen e përgjithshme që ngriti Avokati i Mbrojtjes sesi të veprojë me raste tilla.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit për sugjerimin. Ne do të merremi me këtë pikë me të, patjetër. Por është mirë që në procesverbal ta kemi të shënuar se cili është përkthimi i fjalës që ka përdorur atëherë që është pra në anglisht dhe pastaj mund ta sqarojmë më tej.

Pra, znj. Sekretare me tha se ekziston mundësia që të dyja deklaratat të vendosen krah për krah në anglisht dhe në shqip në ekran, por kjo mund të ketë nevojë për edhe versionin në shqip që ta dimë se në cilën faqe është dhe në cilin rresht nëse mund të na e jepni.

Z. VON BONE: [Përkthim] Kjo mund të jetë edhe çështje abstrakte, por duam që ta kemi zgjidhur edhe për dëshmitarë të tjerë në të ardhmen në dallim nga rastet në të shkuarën, ku për shembull bëhej fjalë për fjalën mal apo pyll. Por ne do të donim ta dinim si procedurë sesi të veprojmë në të ardhmen.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë them duke parë, duke bërë. Në fillim të zgjidhim këtë problem që kemi këtu apo këtë çështje që na del përpara, kështu që të vazhdojmë njëherë me dëshminë e dëshmitares për sot. Të shohim edhe ndonjë çështje tjetër për përkthimin, por mesa kuptoj unë sot është një tjetër problem nga ajo që kemi diskutuar herën tjetër. Nuk mendoj se janë të ngjashme.

Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, versioni në gjuhën shqipe është faqja 20, rreshti 6 deri në rreshtin 8, në veçanti kjo fjalë del në rreshtin 8.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe për cilën fjalë bëhet fjalë?

Z. PELAJ: [Përkthim] Fjala në shqip është *[REDAKTUAR]*.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e shoh.

Z. PELAJ: [Përkthim] Është në rreshtin 8.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e shoh.

Z. PELAJ: [Përkthim] Faleminderit e nderuara Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit që na e nënvizuat.

Pyetja që kam për përkthyesin apo përkthyesen është nëse mund të na e përkthejë fjalën *[REDAKTUAR]* në anglisht.

PËRKTHYESJA: [Përkthim] Shënimi i përkthyeses është që në këtë rast jemi të instruktuar që të konsultohemi dhe pastaj do

ju japim përgjigje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E dëgjuam të gjithë përgjigjen kështu që të durojmë pak, të presim për përgjigjen.

A mund të më thoni sesa kohë duhet?

PËRKTHYESJA: [Përkthim] Nuk jemi të autorizuar që pa u konsultuar të japim përkthimin e një termi. Do t'ju japim përgjigje në momentin e duhur. Ju mund të vijoni me procedurën dhe me ta sqaruar këtë gjë do t'ju informojmë me shpresë shumë shpejt.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk është se e kemi kohën me pakicë për momentin. S'është urgjente. Do të vazhdojmë dhe pastaj do të shohim se si.

Në rregull.

Z. avokat, sa i takon pyetjes suaj të përgjithshme, do t'ju japim përgjigje. Ndërkohë po presim dhe për përgjigjen për përkthimin e fjalës. Ajo që do të bëjmë është që t'i kërkojmë dëshmitares të vijë në sallë dhe të vazhdojmë me dëshminë e saj.

Mirë në rregull.

Do të rikthehemi në seancë publike.

Znj. Sekretare ju lutem të kalojmë në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës jemi rikthyer në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.

Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqëroheni dëshmitaren të hyjë në sallë.

[Dëshmitarja vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. dëshmitare mirëmëngjes. Mirë se jeni rikthyer në Dhomat e Specializuara.

A patët kohë me pushu?

DËSHMITARJA: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. dëshmitare.

Sot do të vijojmë me dëshminë tuaj. Tani i ka ardhur radha Gjykatësve që t'ju bëjnë disa pyetje dhe do të përpiqemi që të mësojmë disa hollësi, të sqarohemi për disa pjesë të dëshmisë tuaj.

Ju rikujtoj që jeni ende nën betim për të thënë vetëm të vërteten. E kuptoni këtë?

DËSHMITARJA: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

DËSHMITARJA: W04676 [vazhdim]

Pyetje nga Trupi Gjykues:

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Na duhet që të zgjidhim një tjetër çështje. Jemi në seancë private. Nëse më lejoni pastaj do t'ju kthehem.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çdo gjë që keni thënë do të redaktohet dhe nuk do të transmetohet apo do të dalë jashtë sallës.

Duhet në fakt, duhet të kisha kërkuar unë më herët që të kalonim në seancë private. Megjithatë pa problem sepse do të redaktohet kjo pjesë edhe nuk do të dalë jashtë.

Pra thatë se ka *[REDAKTUAR]*

Mund të thoni diçka më shumë për këtë?

Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] *[REDAKTUAR]* mund të shpjegoni këtë frazë diçka më shumë?

Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ja këtë do të doja që të - këtë shpjegim doja për ta kuptuar në

mënyrë më konkrete. Faleminderit.

Sa i takon *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Pë. Siç e ceka më herët, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Dhe po e ritheksoj
që *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

T'i kthehemi tani sa vijon. Dje diskutuam që *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* transkripti në një vend për shembull se e kemi diskutuar disa herë, është në faqen 12, rreshtat nga 20 deri në 22. Lind pyetja ime lidhur me këtë për t'u sqaruar d.m.th. është sa vijon:

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në fakt dy herë e thatë dje dhe kur pamë deklaratën e intervistës që i keni dhënë ZPS-së – Trupi Gjykues pra e ka lexuar një pjesë të deklaratës që edhe mund të jetë mospërputhje po mbase dhe nuk është mospërputhje prandaj dhe desha që ta diskutonim bashkë për ta kuptuar më mirë atë që thatë më përpara.

Pë. Nëse mund të shtoj, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* dhe fillimisht e *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Pra vetë më ka thanun, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pyetja ime ka të bëjë me momentin në kohë kur ka ndodhur kjo, për momentin kohor. Në fakt do të lexoj nga intervista 076539-TR-ET, Pjesa I, faqja 16, rreshti 8, po kështu dhe faqja 15 e Pjesës I, rreshti 19, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Sepse keni përmendur datat konkrete *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Do të doja një shpjegim lidhur me këtë, për këtë mospërputhje kohore.

Pë. Po, e nderuara Gjykatëse, qysh e kam thonë edhe në deklaratën time, edhe dje po ashtu e kam përsërit ekzakt apo datën e saktë kur ka ardhun. Unë edhe sot nuk muj me e mbajt në mend. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Nëse ju kujtohet edhe dje, në një fotografi që më është dhënë ka qenë një datë 07/07/1999, po as atë datë nuk e maj mend *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Prandaj edhe njëherë po e them që ende e kam të pasaktë datat ekzakt cila ka qenë kur e kemi bo *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Një është e vërtetë që po, e kemi bo *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* po atë ditë, po me datë e di që muji korrik ka qenë, po saktë data për besë dhe po e them kështu zëshëm që nuk më kujtohet data. Po e di që ka qenë ajo periudhë e javës dytë apo mesit të korrikut të vitit 1999.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Kam tani – dua t'i drejtohem përkthyesve.

Do ta bëjmë në një moment të mëpasshëm sepse për ta diskutuar këtë çështje do të duhet që të dalë dëshmitarja nga salla. Kështu që unë preferoj që të vazhdojmë me dëshminë, pastaj do ta diskutojmë mes nesh më vonë.

Shumë mirë atëherë. Znj. dëshmitare, dëshiroj t'i kthehemi një sqarimi. Pra t'i kthehem diçkaje që u diskutua dje sa i takon shkakut të vdekjes së *[REDAKTUAR]* Dje në transkriptin në faqen 51, rreshtat 14 deri në 21 [sipas përkthimit] ju thatë se nuk u diskutua aty se cila ishte arsyeja, shkaku i vdekjes së tij.

Më lejoni që t'jua rifreskoj kujtesën duke lexuar deklaratën që ju i keni dhënë Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Me të njëjtin numër ERN-je, znj. Sekretare, është Pjesa 1, faqja 17. Ju lutem nëse mund ta nxjerrim në ekran. Faleminderit. Këtu kërkoj që të kalojmë tek rreshti 7.

Këtu bëhet pyetja nëse ai erdhi që t'ju kërkonte ndihmë – "Kur *[REDAKTUAR]* jua bëri këtë kërkesë, a u diskutua ndonjë gjë tjetër"?

"Unë -- nuk më kujtohet hollësitë, nuk hyra në hollësi, nuk fola në hollësi *[REDAKTUAR]*, por më kujtohet, më kujtohet. *[REDAKTUAR]*

U përgjigje:

"Ai më tha vetëm që e kanë mbajt në burg *[REDAKTUAR]*

A mund të konfirmoni se këtë ka thënë ai? Sepse dje nuk u diskutua faktikisht për këtë aspekt, për këtë pjesëz.

Pë. Nuk u diskutu se s'mu bo pyetja direkt në lidhje me këtë fjali. Po kjo ka qenë përgjigjja mbas pyetjes time se ç'ka ka ndodh. Dhe po, ka qenë në burg dhe kaq ka përfundu shpjegimi i *[REDAKTUAR]*, me këtë fjalë. Kurrgjo diçka ma shumë dhe asnjiherë mo nuk e ka diskutu *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. dëshmitare. Thjesht desha vetëm të sqaroj se ai e tha këtë në atë rast meqë kjo dje nuk u përmend. Ju faleminderit.

Dua gjithashtu t'ju kërkoj një sqarim në lidhje me rolin tuaj në procesin e zhvarrimit. Dje dhe i referohem transkriptit, faqe 13 dhe rreshtat 14 deri në 18, ju paraqitët disa arsye pse e ndihmuat tash *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Dhe në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së, Pjesa 1, nga faqja 17, rreshti 18, deri në faqen 18, rreshti 2, ju thoni se shkuat në zhvarrim për arsye se rrethanat, arsyet, shkaku i vdekjes duhej të hetoheshin.

Pë. Po, e nderuara Gjykatëse e kam thënë dhe po ashtu i kam rekomandu që për këtë vdekje të dyshimtë duhet të njoftohen autoritetet si për çdo vdekje tjetër të dyshimtë në Kosovë që

ka ndodhë gjatë luftës në Kosovë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe në dritën e kësaj, mund të ngrihet pyetja sepse ju dëgjova që thatë se ishit aty për ta zhvarrosur kufomën dhe për t'i dhënë kufomës një vend tjetër pushimi, paqeje dhe dje diskutuam - i referohem tani faqes 23, rreshti 24-25 dhe faqes 24 [sipas përkthimit], se ishte e dukshme në anën e majtë të trupit të *[REDAKTUAR]* dhe fotografinë që po e përmend këtu është ajo me numrin SPOE00209318 – pra se ishte e dukshme *[REDAKTUAR]* në anën e majtë të trupit të tij dhe u diskutua se mund të ishte një plumb. Ju dëgjova që thatë se, "nuk e keni ditur shkakun e vdekjes", mirëpo se ky mund të ketë qenë një prej shkaqeve.

Pyetja ime është kjo: A nuk do të ishte e logjikshme *[REDAKTUAR]* për të pa nëse *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* d.m.th. për ta parë pjesën tjetër të trupit të viktimës. A ka ndonjë arsye sepse nuk është bo kjo?

Pë. Në raste të tilla, ne mund të ngrisim hipoteza të ndryshme mbi shkakun e vdekjes. Siç e kam thënë dhe prapë po e them, asnjëri prej neve nuk ka qenë ekspert i shikimit sipërfaqësor të trupit. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Mirëpo për ta vërtetu këtë që familjarët e thonin është dashtë me iu bo autopsi e trupit *[REDAKTUAR]* Ajo autopsi kurrë nuk është, nuk është bo. Prandaj

shiqimi i jashtëm nuk e ka dhënë dhe nuk ka mujt dhe s'ka logjikë që e vërteton nëse *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Dhe po ashtu është tepër e rëndësishme sepse ka qenë procesi i dekompozimit të trupit. Nuk kanë vazhdu tutje përveç shpalosjes të kësaj pjese të trupit *[REDAKTUAR]*. Nuk ju kanë desh pantollat komplet për me pa apo nuk ju kanë hjekë komplet teshat me pa edhe gjoksin apo pjesën e shpinës, d.m.th. ka qenë një pamje sipërfaqësore *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* se mund të ketë kjo vrimë mund të jetë shkaktu nga ndonjë plumb. Por kjo duhet me u vërtetu me shkencë, jo vetëm me pamje vizuale kështu prej syrit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. U bënë 8 fotografi atë ditë. I referohem transkriptit faqja 21, rreshtat 12 e më tej, faqja 20, rreshtat 8 dhe faqja 20, rreshtat 3 edhe 4. Pastaj faqja 22, rreshti 18. E kemi diskutuar këtë gjithë kohën.

*[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Pë. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* ku fotografia e parë e shpjegon vendvarrimin dhe fotografia e fundit komplet nxjerrjen e

kufomës nga varri. D.m.th. një proces të identifikimit të kohës së zhvarrimit, identifikimit të kufomës dhe përgatitjes *[REDAKTUAR]* për procedurë të mëtutjeshme të një ceremonie të rivarrimit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në fotografitë nuk shikohen persona të dukshëm, d.m.th. të pranishëm aty. *[REDAKTUAR]* pra që nuk janë marrë edhe personat në fotografi?

Pë. Jo, znj. Gjykatëse *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dje në pyetjen e Avokatit të Mbrojtjes, ju përmendët njerëzit që ishin të pranishëm gjatë zhvarrimit. Në intervistën me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Pjesa 2, faqja 7, rreshti 20, ju përmendni një person *[REDAKTUAR]* si të pranishëm. Ndoshta është shkruar gabimisht emri i këtij personit, nuk e di. Po a mund të na thoni nëse ai ka qenë i pranishëm ose jo?

Pë. Është shkruar gabim. Emni i tijna, emnin të cilin unë e maj në mend sepse jemi konë shtatë-tetë persona, s' kemi qenë

më shumë. Është *[REDAKTUAR]*, jo *[REDAKTUAR]*. Sigurisht është keqinterpretim i emrit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit për sqarimin.

Dje faqja 63 e transkriptit, rreshtat 9, 10 dhe gjithashtu faqja 62, rreshtat 18 dhe 19, ju thatë, dëshmuat këtu se e identifikuat kufomën apo trupin *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Në intervistën me Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe i referohem Pjesës 2, faqes 17, rreshtat 9 deri në 11 të asaj interviste.

Mund ta vendosim këtë faqe në ekran znj. Sekretare.

Fillon tek rreshti 7.

Pyetja u bë kështu:

*[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Pë. Po intervistën të cilën e kam dhënë para Prokurorit të Dhomave të Specializume dhe shpjegimi dje që e kam bo ndërlidhem tek periudha kur më është bo pyetja, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Në vendngjarje, në vendvarrim, identifikimi i trupit *[REDAKTUAR]* ka qenë lehtë i identifikueshëm, lehtë i identifikueshëm në rroba, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* dhe lehtë i identifikueshëm *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ju dëgjoj se ç'thoni. Por për mua pyetja këtu është shumë e qartë:

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani ndoshta duhet ta kisha bërë këtë më herët, këtë pyetje.

Në atë kohë, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Jo, e nderume Gjykatëse, sepse ne sapo kishim dalë prej luftës dhe *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. dëshmitare. Tani do të kalojmë diçka që u diskutua dje dhe në lidhje me çka do të doja të marr pak më shumë shpjegime. Është qebja që u diskutua disa herë. Avokatja e Viktimave bëri pyetjen në lidhje me qeben në faqen 40, rreshtat 19 dhe 20 të transkriptit. Përgjigjja nuk ishte plotësisht e qartë për ne, prandaj dua që ta sqarojmë pak më hollësisht. Gjithashtu përmendet në faqen 17, rreshti 6 i transkriptit, faqja 25, rreshti 23, d.m.th. gjithandej në transkriptin e djeshëm.

Qebja që ishte përdorur, çfarë lloj qebjeje ishte? A ishte diçka që zakonisht do të mund dikush ta përdorte edhe në shtëpi për të fjetur apo ishte ndonjë qebe që përdorej për kafshët, d.m.th. çfarë lloj qebe ishte kjo nëse ju kujtohet dhe nëse mund ta kujtoni?

Pë. Nuk muj me precizu saktë çfarë lloj qebe ka qenë, a ka qenë qebe e kafshëve apo ka qenë qebe që ne i përdorim

zakonisht në shtëpi. Muj me e përsërit që ka qenë qebe e kaltër e mbylly rpër nga ngjyra dhe ka qenë në proces të kalbjes së sajna. Çfarë fije sintetike apo çfarë tekstili ka pasë nuk e di, nuk muj me dit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Sekretare, ju lutem vendosni në ekran dy fotografi, njëra ka shumë numra po do t'i them, është njëra nga fotografitë e ZPS-së SPOE00209313 deri në 320 dhe konkretisht një që mbaron me numrat 9317. Dhe e dyta me numrin SPOE00128386 deri në 00128420 dhe është ajo që përfundon me numrat 8401.

Pyetja ime është si vijon: Me sa dini ju, a mendoni se përngjajnë njëra me tjetrin në këto dy fotografi? D.m.th. shohim qeben në të dy fotografitë.

Pë. Për nga ngjyra mund të ngjasojnë me njana-tjetrën po për nga sintetika nuk e di. Pak a shumë për nga ngjyra mund të ngjasojnë me njana-tjetrën. Po flas për ngjyrë, nuk...

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ta lëmë aty.

Faleminderit znj. Sekretare, mund t'i heqim fotografitë nga ekrani.

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Pë. Jo, znj. Gjykatëse nuk e di. Po ta dija do ta tregoja të vërtetën, por nuk e di.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Në deklaratën e dëshmitarit dhënë Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Pjesa 2, faqja 5, rreshtat 9 dhe 10, ju keni thënë:

"Ishte thjesht e dukshme për mua që *[REDAKTUAR]*, dhe aty flitet për *[REDAKTUAR]*. "Pra ishte për mua e qartë *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Pë. Po flasim për dy gjëra të ndryshme. Për përshtypjen time dhe për bisedën *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* nuk e ka pasë asnjiherë.
Tash njëri ndër dije ndër mendje mundet me pasë një milion mendime, por kur nuk i diskuton ato mendime me kurrkënd sepse nuk ishte e rrugës e imja që në *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kam plotësisht e vetëdijshme që po na dëshmoni për momente mjaft të dhimbshme. Dhe e çmojmë dëshminë tuaj, po thjesht këto aspekte duhet t'i diskutojmë dhe duhet t'ju parashtrojmë pyetje. Gjithsesi e kemi parasysh këtë.

Atë që sapo na e shpjeguat, e thatë me fjalë të ngjashme edhe në Pjesën 2, faqja 4 të deklaratës se *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Pë. Afër njani-tjetrit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur

thoni “afër” e shikojmë me duar që tregoni se kanë qenë afër *[REDAKTUAR]*, d.m.th. kanë qenë të shtrirë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

D.m.th. pyetja ime është: A ishin të shtrira kufomat njëra afër tjetrës, ngjit njëra me tjetrën?

Pë. Gjithmonë prej vendit të ngjarjes dhe fotografinë të cilën e kam përpara, kur kemi fillu komplet qeben me e largu dhe me shty pak anash se u deshke me nxjerrë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* dhe ka thonë, “Mos zhvarrosni tutje sepse është edhe një kufomë afër tijna”. Dhe e ka ndërpre procesin aty për mos me e dëmtu.

Te ne varrezat janë afër ku varrosen dy persona, varrosen afër njani-tjetrit, nuk ka varrim përfuni apo përmbi, do të thotë gjithmonë varret janë afër njani-tjetrit. Dhe natyrisht që nuk kemi prekë na tutje në atë pjesën tjetër të varrit me mendimin dhe sipas supozimit të *[REDAKTUAR]* që këtu është edhe një trup tjetër i varrosun.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Mirë pra, a ishte e qartë për *[REDAKTUAR]* cilën prej dy kufomave duheshe me e shplu për me e nxjerrë nga varri?

Pë. Edhe njëherë të lutem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e kuptoj. Nuk dua që ta them, t’jua sugjeroj unë përgjigjen faktikisht. Një moment.

*[REDAKTUAR]* a e dinte se cila kufomë ishte pra kufoma pra *[REDAKTUAR]*

Pë. Unë jam e bindur që me *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* e dinte se në cilën pjesë të varrezës gjendej trupi *[REDAKTUAR]* për shkak të formës dhe mënyrës së orientimit tonë direkt tek varri.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Mikrofonin e kam ndezur – dëgjohem? Po, shumë mirë.

Kush e raportoi kufomën e dytë? Ose më saktë kush u raportoi autoriteteve se në varr ishte dhe një kufomë e dytë?

Pë. Gjithë raportimin e ka bo *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pati ndonjë arsye të veçantë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Pë. Rekomandimi im mbasi e kemi kryer procesin e zhvarrimit dhe rivarrimit ka qenë që – i kam rekomandu *[REDAKTUAR]* që të procedojë tutje në raportimin e rastit tek autoritetet sepse kishte të bënte me *[REDAKTUAR]*, pikërisht pikësëpari dhe e dyta për shkak të drejtimit dhe për shkak të informatave që ai kishte për procesin dhe për vendndodhjen e *[REDAKTUAR]*, ai ishte dëshmitar i drejtpërdrejtë i gjithë ngjarjes. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* për shkak që ai ishte dëshmitar, e dinte ku është i varrosun, në cilën anë është i

varrosun, dhe unë i kam rekomandu, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* ta raportojnë tek autoritetet sepse *[REDAKTUAR]*
informacione mbi vrasjet e popullatës civile në Kosovë nga ana e regjimit të Milloshevviçit dhe masakrave të ndryshme që kishin ndodhë sidomos nga 24 shkurti deri në përfundim të bombardimeve dhe përfundimit të luftës në Kosovë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Kam një pyetje të një natyre më të përgjithshme. Ka të bëjë me pjesëmarrjen tënde *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Me një fjalë ndryshon nga kjo për të cilën po diskutojmë tani po në Pjesën 1, faqen 18, rreshtat 14 dhe 15, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* si zhvillohej nëse mund të thoni diçka për këtë?

Pë. Nëse më lejon pak më gjatë që ta kem përgjigjen në pyetjen tënde.

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* ku përmbi 100 mijë popullatë civile janë shty me dhunë përmes bombardimeve, vrasjeve, masakrave, dhunimeve me lëshu Kosovën. Po flasim gjithmonë për një rrugë regjionale e cila ka qenë rruga e ferrit. Vetëm ata sot që janë të gjallë në mesin tonë mund ta shpjegojnë shumë mirë se çfarë ka ndodhë në atë rrugë.

Prej Koliqit e deri në hyrje të Prishtinës, nga data 1 deri me 10 prill ka qenë ofensivë shumë e ashpër e forcave policore, ushtarake, paramilitare, civile të Serbisë ndaj popullatës civile në Kosovë. Dhe në këtë periudhë kemi qindra

të vrarë, të plagosun e që besa edhe të zhdukun sot atë ditë. Kemi dhjetëra gra, nana, e vajza, të cilat kanë qenë të dhunume – po flas për periudhën prej 1 deri më 10 prill. Dhe këto masakra dhe kjo luftë e egër e Serbisë ndaj popullatës civile e ka pasë një qëllim të vetëm, ka qenë pastrimi etnik përmes formave, mënyrave dhe metodave çnjerëzore që regjimi i Milosheviçit i ka përdorë në Kosovë. Për këto metoda –

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. dëshmitare, ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres. Ju falënderoj për këto që na thatë, por dua që t'i kthehem pyetjes. Mbase kjo mund të shërbente si një hyrje për t'i dhënë përgjigje pyetjes dhe do t'jua lejoja në këtë rast, por do të doja që të fokusoheshit tek pyetja.

Pë. Kjo nuk ka qenë vetëm një kufomë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Po ashtu shumë interesant me shpjegu e besoj që është edhe *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë. Po e lë me kaq. Znj. dëshmitare, kemi edhe një çështje për të diskutuar në lidhje me përkthimin kështu që do t'i kërkoja Asistentes të sallës që t'ju shoqërojë të dilni nga salla. Shpresoj të jetë shumë e shkurtër koha se është më mirë që mos ta dëgjoni atë që do diskutojmë.

Pastaj do t'ju kërkojmë që të hyni prapë në sallë.

[Dëshmitarja përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Jemi tani në një seancë të mbyllur, private pra dhe do të diskutojmë me zonjën përkthyese për të na thënë nëse është bërë diskutimi sa i takon fjalës që ka nënvizuar ekipi i Mbrojtjes.

PËRKTHYESI: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, një anëtare e ekipit më ka informuar që përkthimi i saktë për këtë fjalë do të ishte *[REDAKTUAR]* pra *[REDAKTUAR]*.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Hë për hë, do të thosha që kjo është fjala që duhet të përdorim jo tani po më pas. Do të drejtohemi me postë elektronike për qasjen më në përgjithësi sa i takon problemeve të përkthimit po ka edhe udhëzime të përgjithshme të cilat i kemi tashmë, që ekzistojnë, të cilat na ndihmojnë për tu marrë me çështje të

përkthimit.

Në rregull atëherë. Më kanë mbetur pak a shumë dhe katër pyetje, pesë pyetje. Do të kërkoj që të rikthehet në sallë dëshmitarja për të kaluar në Pjesën 1, faqe 19, rreshti 18 dhe fjala *[REDAKTUAR]* në anglisht do ta përkthejmë si *[REDAKTUAR]*

[Dëshmitarja vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u rikthyet.

Po a mund t'i jepni përgjigje pyetjes në vijim.

A e dini se cila ishte *[REDAKTUAR]*

Pë. Jo, znj. Gjykatëse nuk e di.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ju kujtohet nëse *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Pë. Kur është diskutu për *[REDAKTUAR]*, gjithmonë ka qenë diskutimi i tijna që e kam raportu rastin, po hala kurrkush s'më ka thirrë për rastin e *[REDAKTUAR]*. Edhe ka qenë një kështu zhgënjim total nga ana e tijna edhe të familjarëve të tijna për mostrajtim të rastit, gjithmonë po flas për *[REDAKTUAR]* Ka qenë i mbyllun, ka qenë i rezervum në diskutim dhe nuk ka dashtë asnjiherë me marrë si temë rastin *[REDAKTUAR]*. Ndoshta rrethanat, ndoshta ka pasë arsye të ndryshme, mirëpo nuk ka leju me hy tutje në diskutim për *[REDAKTUAR]*.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më lejoni t'jua rifreskoj kujtesën pa pasur nevojë që ta nxjerrim këtu në ekran. Por është po e njëjta – s'është vetëm një frazë d.m.th. është e njëjta intervistë, Pjesa I, faqja 19, rreshti 17. *[REDAKTUAR]* ka thënë,

"Pra e vetmja gjë që më ka thënë *[REDAKTUAR]* sipas tij *[REDAKTUAR]*

Edhe pyetja që kam është kjo: Mund të thuash diçka më shumë për *[REDAKTUAR]*? *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Në deklaratën time dje, unë kam shpjegu rreth
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Që kur ke diskutu *[REDAKTUAR]* kështu ka qenë ajo përgjigjja e tijna. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* A po kupton? Ndoshta që *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* s'po e dijna, a po kupton? Ai e ka pasë brengën ma të madhe gjithmonë në këtë pyetjen pse. Dhe këtë pyetjen pse jemi të gjithë këtu

bashkë *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. dëshmitare. Do të kalojmë tani në një temë tjetër.

A kishin frikë anëtarët e familjes *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* lidhur me atë çka i kishte *[REDAKTUAR]*?

Pë. Pikërisht kjo mbyllja e diskutimit se çka i kishte ndodhë *[REDAKTUAR]*, natyrisht që kanë pasë frikë *[REDAKTUAR]*.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e keni përmendur edhe në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së, në Pjesën 3, faqja 3 – s'ka nevojë ta nxjerrim në ekran – por rreshti 23 deri në rreshtin 25, por edhe në Pjesën 3, faqja 4, rreshti 1 deri në 5, e përmendni fjalën frikë, frikën.

Pyetja që kam është kjo: Frikë nga çfarë? Dhe frikë për kë? Për kë kishin frikë?

Pë. Nëse më pranohet kjo përgjigje znj. Gjykatëse do ta jepja, këtë frikë ma mirë do ta dinë me shpjegu nëse do të jenë dëshmitarë të kësaj Gjykate.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Natyrisht unë nuk dua që të hamendësohen gjërat, të merren me mend, po pyetja është e qartë. Ju vetë e dini se për kë kishin frikë?

Pë. Personalisht për emër të caktum jo. Për individ të caktum apo grup të caktum, jo asnjëherë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ose individ ose grup.

Pë. Asnjëherë s'e kam ditë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po nga se kishin frikë a e di? Çfarë, çfarë - nga se frigoheshin?

Pë. Jam e bindun se frigoheshin nga raportimi i rastit që e kanë bo. Dhe kërkesa për të mësuar dhe ta dinë të vërtetën se çfarë *[REDAKTUAR]*. Dhe po flas gjithmonë në rrethanat dhe periudhën e mbas-luftës menjëherë në Kosovë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më lejoni t'jua rifreskoj kujtesën. Pjesa 3, faqja 10 e deklaratës që i keni dhënë Zyrës së Prokurorit të Specializuar, në rreshtin 9 deri në 13, keni thënë që:

"Kishin frikë, ndjenin frikë anëtarët e *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* që të mos diskutonim këtë çështje *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* edhe ata kishin frikë se mos u ndodhte diçka".

Siç e kuptoj nga deklarata e dëshmitarit pra që i keni dhënë Zyrës së Prokurorit të Specializuar, pra e keni nënkuptuar se mund tu ndodhte ndonjë *[REDAKTUAR]*.

Pë. Këtë fjalën "frikë" është bukur e madhe me e shpjegu dhe nuk është frika vetëm për vetveten. Dhe diskutimi kur është bo gjithmonë për këtë rast me *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* kanë thënë, "Shuj, çfarë se *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]"*. E kishin frikën për të gjalltit që rastin të cilin e kishin raportu dhe mospërgjigjja nga ana e autoriteteve për vite, vite, vite, vite, vite të tana natyrisht që familja kaloi në frikë të përgjithshme. Kjo është frikë normale, të cilën e kanë pasë si familje, prandaj dhe kanë qenë të mbyllun njëlloj betonizimi për të diskutu ma tutje apo detale se çka mund të ketë ndodhë në lidhje me rastin *[REDAKTUAR]*.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ti vetë a ke frikë nga dikë, nga dikush për shkak të faktit se je dëshmitare në këtë çështje?

Pë. Gjithmonë frika ekziston. Dhe kjo frikë ekziston për shkak të keqkuptimit që njerëzit mujn me kriju në mendjet e tyne. Gjithmonë kjo frikë ekziston për shkak të të bërit me gisht ka ti që ti je, mundesh me qenë një tradhtare, mundesh me qenë një bashkëpunëtore, mundesh me qenë një person që ia don të keqen, një person të cilit i ke tradhëtu vlerat e lirisë e të luftës. Po flas gjithmonë nga botëkuptimi se çfarë ekziston tek ne. Unë sot këtu jam vetëm në cilësinë e dëshmitares për një ngjarje ditore, për një proces zhvarrimi dhe një proces varrimi, për atë në të cilin kam marrë pjesë. Dhe duke qenë pjesë si dëshmitare pjesë e Gjykatës Speciale, natyrisht që çdo herë do të ekzistojë frika tek unë për shkak që Kosova është vend shumë i vogël, nuk është vend i madh. Ne njihemi mes vete shumë mirë, shumë lehtë, po ashtu edhe

përditshmëria jonë në punë të ballafaqon dhe has në persona të ndryshëm që fare, fare nuk e kanë idenë dhe nuk e kuptojnë se në çfarë cilësie mund të ftohet një njeri si dëshmitar i Gjykatës Speciale. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Unë kam frikë dhe gjithmonë do të ekzistojë kjo frika, të keqkuptimit të kujtdo ndaj meje të qenit sot dëshmitare në këtë, në këtë Gjykatë.

Dje e kam thonë dhe do ta përsëris edhe sot, -- e kërkoj edhe unë, po drejtësinë mbi këtë vërtetë do ta kërkojmë që të gjithë ndaj kujtdo dhe në çfarëdo procesi dhe periudhe ka ndodhë çfarëdo rasti që sot janë në kërkim të vërtetës dhe vetëm të vërtetës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. dëshmitare. Dëshiroj të theksoj një shqetësim meqenëse po flasim për frikën. Prokurores në Pjesën 4 të deklaratës që i keni dhënë i keni thënë. Pra pyetjes që ajo ka bërë, "Keni ndonjë gjë për të sqaruar apo për të shtuar"? Ju i jeni përgjigjur:

"E kam një shqetësim për shkak të situatës së re", dhe
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Është faqja 1 dhe faqja 2 se nuk e thashë në fillim. Po këtë e them për procesverbalin tonë këtu.

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Pë. E shpjegova ma herët që çdo person që ftohet si dëshmitar nga Gjykata Speciale, shihet me një sy krejt ndryshe në Kosovë. Dhe kur një person shihet krejt ndryshe në Kosovë dhe perceptohet ndryshe dhe trajtohet ndryshe, natyrisht që ekziston frika e përgjithshme. Nuk e di se cilat janë procedurat dhe proceset brenda në Gjykatën Speciale. Nëse i merr sot portalet me i lexu, nëse i merr sot televizionet me i shiqu, nëse i merr sot analistët me i dëgju, të gjithë ne që na keni ftuar si dëshmitarë në këtë proces, tashmë jemi të shpallun edhe si bashkëpunëtorë të Gjykatës Speciale që ne i kemi deponu në dosje ne Gjykatën Speciale, që ne i kemi kontribu në ngritjen e aktakuzës kundër krerëve të UÇK-së dhe kundër UÇK-së. Ne as nuk jemi ata që kemi kontribu dhe as nuk kemi deponu asnjë dëshmi dhe asnjë dokument. Gjykata Speciale tashmë është proces dhe ne si dëshmitarë në momentin kur jemi ftu ju kemi përgjigj Gjykatës Speciale në cilësinë e dëshmitarit.

Prandaj kjo frika e etiketimit dhe kjo frika të shpalljes bashkëpunëtorë dhe tradhtarë gjithmonë do të ekzistojë dhe gjithmonë do të jetë në mesin tonë që sot jemi dëshmitarë të Gjykatës Speciale. Është kjo frikë e përgjithshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. dëshmitare. Kam një pyetje të fundit Ka të bëjë me deklaratën që i keni dhënë *[REDAKTUAR]*.

Prokurores asokohe i keni thënë sipas deklaratës që i keni dhënë ZPS-së këtu se *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të shikoj kolegët nëse kanë pyetje lidhur me këtë.

GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Faleminderit znj. Kryetare. Mund të kem dy pyetje shtesë.

E para: *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Dhe mesa keni ju dijeni,
*[REDAKTUAR]*

Pë. Jo, sa e di unë, jo. Jo.

GJYKATËSI DEKKERS: [Përkthim] Mirë. Faleminderit shumë.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit znj. Kryetare.

Znj. dëshmitare, gjatë zhvarrimit, a dëgjuat nga ata që po e zhvarrosnin kufomën, n.q.s. kishin përshtypjen, apo që kishin parë, apo që kishin kuptuar se ndonjëra nga duart, sidomos *[REDAKTUAR]*?

Pë. Jo, jo s’e kam dëgju. Nuk e kam dëgju. Nuk e kam dëgju, po edhe krejt procesi ka shku me, me, *[REDAKTUAR]* Edhe s'ka pasë asi përqendrimi me ja kontrollu. Nuk e kam dëgju. Sa e mbaj në mend unë jo.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. dëshmitare, a ka ndoshta diçka që ju vetë doni ta thoni, dëshmoni që ne nuk e kemi mbuluar si temë dhe që ju ndoshta doni ta ndani me ne.

Pë. Jo, e nderuara Gjykatëse, nuk kam asgjë në lidhje me këto përveç kërkesës e që tashmë e kam edhe amanet, të vërtetës dhe të drejtësisë për këtë vërtetë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atë po e bëjmë pikërisht në këtë moment.

Tani do të kërkoj që të kalojmë përsëri në seancë publike.

Znj. Sekretare të kalojmë në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. dëshmitare, erdhëm në përfundimin e dëshmisë suaj. E di që procesi i dhënies së dëshmisë është i lodhshëm. Ju falënderoj për përpjekjet që bëtë për dhënien e dëshmisë dhe që na ndihmuat në përpjekjet tona për ta gjetur të vërtetën sikurse thatë edhe vetë pak përpara.

Ju faleminderit shumë. Ju dëshiroj rrugë të mbarë në shtëpi dhe ju rikujtoj dhe njëherë se nuk duhet ta diskutoni dëshminë tuaj me askënd. Edhe njëherë faleminderit. Tani ndihmësja do t'ju përcjellë jashtë sallës së gjyqit.

DËSHMITARJA: Faleminderit.

[Dëshmitarja përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, ndihmëse.

Po, është pothuajse fundi i kësaj seance dhe të seancës dëgjimore të sotme. Po shikoj nga palët n.q.s. kanë diçka për të ngritur.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të ngritur e nderuara Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po Avokatja e Viktimave?

Znj. ZEGVELD: Jo, nuk kemi asgjë për të ngritur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokati i Mbrojtjes?

Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të ngritur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E diskutuam informacionin që do të ndahet për përkthimin. Do të vazhdojmë të hënën në orën 9.30 me dëshminë e dëshmitarit W04391.

Falënderoj palët, Avokaten e Mbrojtësve për praninë e

tyre. Falënderoj përkthyesit dhe fleksibilitetin e tyre sidomos që na ndihmuat në atë çështjen e përkthimit. Falënderoj stenografin, sigurimin dhe ekipin audio-vizual.

Seanca mbyllet këtu.

--- Seanca përfundon në orën 11.10